



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:123904
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05727630

Ac.nr.5074/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.H nga fshati B....., Komuna e Sh....., të cilën me autorizim e përfaqëson B.Rr, avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës - Departamenti i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i përfaqësuar nga S.T, për kompensimin e pagesën shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, C.nr.170/2021, i datës 12.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Shtërpcës - Departamenti i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, C.nr.170/2021, i datës 12.04.2022, dhe gjykohet si në vijim: REFUZHET e pathemeltë kërkesëpadia e paditëses, M.H nga fshati B....., Komuna e Sh....., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditëses t’ia paguaj në emër të pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune në vlerë prej 405.37 € me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 24.02.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar, C.nr.170/21, i datës 12.04.2022, ka vendosur si në vijim: “ *I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.H nga fshati B....., Komuna e Sh....., DETYROHET e paditura Komuna e Shtërpcës - Departamenti*

i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale që paditësit t'i paguaj kompensimin në emër të pagës jubilarë për vitin e 10-të të punës në shumë prej 405.37 euro. (katërqind e pesëqind e tridhjetë e shtatë cent), me kamatë ligjore 8% nga data e paraqitjes së padisë më 15 janar 2021, vit deri në pagesën përfundimtare brenda 7 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

II. I padituri merr përsipër t'ia kompensojë paditësit shpenzimet e procedurës civile në shumë prej 200.40 euro (dyqind e dyzet e katër cent), në afat prej 7 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit. ''.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet duke e refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësja.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1, pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datën 15.06.2021, ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, ndaj të paditurës Komuna e Shtërpcës - Departamenti i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, për kompensimin e pagës jubilarë për 10 vitë përvojë pune në shumë të përgjithshme prej 405.37 €, me kamatë vonesë vjetore prej 8%, në vit nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.170/21 i datës 12.04.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara dhe nga deklaratat e palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar faktin se është fakt i pakontestueshëm se paditësja, në bazë të kontratës së punës, marrëdhënien e punës me afat të pacaktuar e ka bazuar në detyrat dhe detyrat e teknikut mjekësor në klinikën e mjekësisë familjare në fshatin D....., Komuna e Sh..... dhe se ajo kishte të drejtë për një çmim jubilar për 10 vjet punë me të pandehurin si punëdhënëse e fundit. Nga provat e administruara si vërtetimi i lëshuar nga Komuna e Shtërpcës, nr. prot 09-030/01 – 12873/20 datë 27.11.2020, kontrata e punës dt.04.01.2012, vendimi i Komunës së Shtërpcës, nr. 09-030-01 -816-22 datë 21 janar 2022, kërkesa për pagesë retroaktive dhe raporti nga banka BRK mbi fitimet neto të paditëses për janar 2020, gjykata gjeti se paditësja

është në marrëdhënie pune tek e paditura, e cila ka përvojë pune mbi 10 vite dhe të njëjtës nuk i është kompensuar shpërblimi jubilar në vlerë të një page bazë, të parapara me nenin 17 par. 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Vendimin lidhur shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, prandaj aktgjykimi i ankimuar është dashur të ndryshohet dhe të gjykohet si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ku nga përmbajtja e ankesës nuk mund të kuptohet se cila dispozitë e procedurës kontestimore është shkelur. Kjo gjykatë konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, ku dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka edhe aktgjykimi i atakuar është dashur të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurës për zbatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me shikim në shkresat e lëndës gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar gjendjen faktike duke vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura nga data 01.07.2004, në pozitën teknikut mjekësor në klinikën e mjekësisë familjare në fshatin D....., Komuna e Sh....., gjë që vërtetohet nga Vërtetimi nr. prot 09-030/01 – 12873/20 datë 27.11.2020i lëshuar nga vetë e paditura, ku vitin jubilar, respektivisht 10 vite përvojë pune e ka përmbushur me datë 01.07.2014, si dhe vërtetohet paga mujore bazë e paditëses në lartësi prej 405.37 €.

Nga gjendja e konstatuar faktike, kjo gjykatë gjeti se nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagës jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritator është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar.

Lidhur me kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e shpërblimit jubilar Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër

faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar konform nenit 195. 1 pika e) e lidhur me nenin 201 pika d) e LPK-së.

Me dispozitat e nenit 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Poashtu me nenin 17 parag.3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Me nenin 17 parag.4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se: Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, edhe pse ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë nga ana e paditëses (Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka hyrë në fuqi më datë 12.06.2018) dhe e njëjta edhe pse është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pathemeltë, për faktin se në këtë rast paditëses nuk i takojnë benefitet nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, duke marrë parasysh faktin se kjo kontratë nuk ka qenë në fuqi, e as ndonjë marrëveshje tjetër kolektive, në kohën kur paditësja ka arritur vitin jubilar për 10 vjet përvojë pune, sepse paditësja 10 vite përvojë pune i ka mbushur me datë 01.07.2014. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar që kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, andaj kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovojë si të themeltë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ndryshuar, duke e refuzuar të pathemeltë kërkesëpadinë e paditëses, si dhe ka vendosur për shpenzimet e procedurës konform nenit 450 të LPK-së.

Gjykata i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore të palës ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5074/2022, me datë 22.05.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v.